

trajtimi i varësisë ndaj drogave etj. Për të mbuluar larminë e nevojave, të cilat mund të paraqisësh, Shërbimi i Provës është gjithmonë në kërkim të shërbimeve të ndryshme, të cilat mund të ofrohen për ju nga organizma të specializuara.

### Të miturit dhe Shërbimi i Provës

Personat në fokus të ndërhyrjes në Shërbimin e Provës janë edhe të miturit që kanë kryer një vepër penale ose janë persona nën hetim/të pandehur.

Specialistët hartojnë raporte vlerësimi për të miturit gjatë fazës së hetimit për prokurorin dhe raporte vlerësimi për gjykatën gjatë fazës së gjyqimit dhe zbatimit të vendimit. Qëllimi i raportit është ardhja në ndihmë për prokurorin/ gjykatën që të marrë një vendim sa më të drejtë dhe të arsyeshëm për këtë



të mitur. Ky mendim ka si synim të ekuilibrojë interesat më të mira për të miturit në shkelje me ligjin, me interesat më të mira për viktimën dhe komunitetin.

### Mbikëqyrja elektronike

Që nga marsi i vitit 2013, Shërbimi i Provës është institucioni realizues edhe i Mbikëqyrjes Elektronike.

Mbikëqyrja elektronike zbatohet nëse ndaj jush është vendosur :

- Masë shtrënguese
- Dënim alternativ
- Dënim plotësues
- Urdhër i mbrojtjes
- Urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes

Kufizimet e përcaktuara në vendimin gjyqësor, mbikëqyren nëpërmjet pajisjes e cila vendoset në trupin e personit nga salla operative e ngritur për këtë qëllim. Pajisja i komunikon sallës operative daljen nga zona e lejuar apo hyrjen në zonën e ndaluar duke treguar vendndodhjen e personit të mbikëqyruar.

- *Kush mund të mbikëqyret elektronikisht?*

Gjykata ose prokuroria kërkojnë zbatimin e mbikëqyrjes elektronike për persona të mitur apo të rritur të cilët paraqesin rrezikshmëri të ulët shoqërore dhe personat të cilët akuzohen për një vepër penale që dënohet jo më shumë se me 5 vjet burgim. Ju duhet të jepni pëlqimin për t'u vënë në mbikëqyrje elektronike përveç se në rastet kur parashikohet në ligj. Aktorët e rëndësishëm të këtij procesi janë Gjykata, Prokuroria, Policia e Shtetit dhe Shërbimi i Provës.

### Si funksionon?

Mbikëqyrja elektronike funksionon nëpërmjet një byzylyku elektronik (njësia personale) dhe një njësie qendrore (njësia e shtëpisë).

Byzylyku elektronik vendoset mbi kyçin e këmbës dhe mbahet në çdo moment. Ai ka peshë të lehtë, është rezistent ndaj goditjeve dhe ujit, gjë që bën të mundur vazhdimin e aktiviteteve normale të përditshme pa u penguar nga pajisja.

Njësia qendrore (njësia e shtëpisë), vendoset në shtëpinë e personit dhe merr sinjale në çdo kohë nga byzylyku elektronik, informacion i cili përçohet drejt sallës operative nga ku bëhet mbikëqyrja elektronike. Nëse largohesh nga zona e lejuar, komunikimi mes këtyre dy pajisjeve shpëputet. Në këtë moment, sinjalizohet salla operative për ndodhinë. Procesi i anasjelltë vlen për hyrjen në zonën e ndaluar. Sinjale të tjera që i dërgohen sallës operative, sipas rastit, janë ato kur pajisja dëmtohet, tentohet të hiqet, lëvizet, apo nëse nuk është e lidhur me energjinë elektrike.

### Çfarë ndodh nëse shkelen kushtet?

Në momentin kur kryen një shkelje të përcaktimeve të vendimit gjyqësor, salla operative konfirmon ndodhinë dhe informon autoritetet përkatëse. Shkelja e detyrimeve, nëse është e qëllimshme apo e përsëritur, mund të të çojë sërish para gjykatës dhe mund të rezultojë në zëvendësimin apo revokimin e mbikëqyrjes elektronike.

### Cila është dobia?

Mbikëqyrja Elektronike ofron një sistem të fuqishëm për përforcimin e efikasitetit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për personat të cilëve iu është kufizuar lëvizja dhe mund të promovojë rritjen e sigurisë publike duke përmirësuar mbikëqyrjen e individëve në komunitet. Gjithashtu, kufizimi i lëvizjes mund të ndihmojë në imponimin e një disipline dhe strukture ditore për të mbikëqyruarit; të ndikojë në thyerjen e trajtave të sjelljes kriminale dhe mund të aftësojë pjesëmarrjen në aktivitete pune, arsimimi apo trajnimi.

### Për më shumë informacion

Për informacion më të gjerë dhe të detajuar, si dhe për të verifikuar nëse i përmbush kriteret ligjore për përfitimin e alternativave të dënimit, lexo Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë (nenet 58, 59, 59/a, 63 dhe 64), ndërsa për detaje në lidhje me Mbikëqyrjen Elektronike lexo ligjin Nr.10 494, dt. 22.12.2011 "Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor"  
Gjithashtu, për një vlerësim më të saktë të rrethanave të tua ligjore, këshillohu me juristin e institucionit të vuajtjes së dënimit apo me avokatin/përfaqësuesin tënd ligjor.

Kontakti Shërbimin e Provës në:  
Telefon: + 355 (4) 2227928  
E-mail: [sekretariadpshp@sherbimiproves.gov.al](mailto:sekretariadpshp@sherbimiproves.gov.al)  
Adresa: Rr. "Jordan Misja", pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda  
Për më tepër informacion, faqja zyrtare në rrjet e Shërbimit të Provës:  
[www.sherbimiproves.gov.al](http://www.sherbimiproves.gov.al)

Ky botim u mundësua nga:  
 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë  
Prezenca në Shqipëri



## Dënimet alternative dhe roli i Shërbimit të Provës



Ky informacion të vlen nëse je person i akuzuar, i pandehur apo i dënuar dhe të shërben për të kuptuar më mirë qëllimin e dënimeve alternative, dhe nëse mund të përfitosh nga to. Gjithashtu, në rast se je dënuar tashmë me një nga dënimet alternative dhe je nën mbikëqyrje, ky informacion i përmbledhur mund të shërbejë më së miri për familjarët e tu, të afërmit apo miqtë, të cilët kujdesen për mirëqenien tënde dhe janë duke të ndihmuar për t'u riintegruar në shoqëri.

### **Çfarë janë dënimet alternative?**

E përbashkëta e dënimeve alternative qëndron në zëvendësimin e dënimit me burgim me mbikëqyrje në komunitet. Kjo të lejon të kryesh një jetesë normale pranë familjes, shkollës, vendit të punës, pranë një qendre rehabilitimi, etj. pra, dënimi kryhet në ambiente jo të izoluar, siç ndodh në rastin e dënimit me burgim. Dënimi me burgim është parë në të shkuarën si masa më e mirë për të rritur sigurinë e komunitetit dhe dënimin e veprimeve kriminale duke synuar uljen apo eliminimin e tyre. Megjithatë, jo gjithmonë ky është rasti. Rezultatet e rehabilitimit dhe riintegritit nëpërmjet izolimit me burgim janë të përziera, që do të thotë se jo gjithmonë ka dhënë efektin e dëshiruar, duke hapur kështu horizonte të reja e duke e zhvendosur theksin e dënimit nga ndëshkimi te trajtimi i shkelësit të ligjit.

### **Kush përfiton?**

Për secilin prej dënimeve alternative ekzistojnë kritere të posaçme të parashikuara në Kodin Penal. Kryesisht, përfitues të tyre janë persona me rrezikshmëri të ulët shoqërore, si dhe persona të cilët shfaqin vullnet për ri-integrim të shpejtë në shoqëri.

### **Çfarë është Shërbimi i Provës?**

Shërbimi i Provës është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, i cili mbikëqyr vuajtjen e dënimeve alternative atëherë kur me anë të një vendimi gjyqësor zëvendësohet dënimi me burgim. Gjithashtu, Shërbimi i Provës është organi realizues i mbikëqyrjes elektronike.

### **Llojet e dënimeve alternative:**

Nëse je nën hetim apo i pandehur, mund të përfitosh,

gjatë fazës së dhënies së vendimit gjyqësor, alternativën e dënimit me burgim, e cila përputhet me veprën penale, dëmin e shkaktuar dhe rrezikshmërinë shoqërore.

#### *- Kryerja e punës me interes publik*

Një nga këto alternativa, e cila jepet gjatë fazës së dhënies së dënimit është kryerja e punës në interes publik. Ajo nënkupton kryerjen e një sasive orësh (nga 40 deri në 240 orë) punë të papaguar në interes të komunitetit, në vend të kryerjes së dënimit me burgim. Zbatimi i këtij dënimi mbikëqyret nga Shërbimi i Provës, në bashkëpunim me qendrat pritëse dhe zgjat deri në përfundimin e sasisë së përcaktuar të orëve dhe kryerjes me sukses të punës së caktuar.

Që të mund të shlyeni dëmin e shkaktuar nëpërmjet punës në interes publik dhe jo me burgim, duhet të mos kesh marrë një dënim me burgim më të lartë se 1 vit. Pavarësisht nga sasia e orëve, puna në interes publik duhet të kryhet brenda një afati prej 6 muajsh.

#### *- Pezullimi i dënimit me burgim dhe vënia në periudhë prove*

Po gjatë fazës së dhënies së dënimit, mund të përfitosh nga pezullimi i dënimit me burgim dhe vënia në periudhë prove, në rast se dënimi juaj me burgim nuk është më i lartë se 5 vjet. Faktorë lehtësues për të përfituar këtë alternativë të dënimit me burgim janë: rrezikshmëria e ulët, mosha, kushtet shëndetësore dhe mendore, mënyra e jetesës dhe nevojat, sjellja pas kryerjes së veprës penale etj. Kjo alternativë parashikon vënien në periudhë prove dhe mbikëqyrjen nga ana e Shërbimit të Provës të ecurisë së përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në vendimin gjyqësor. Periudha e provës mund të zgjasë nga 18 muaj deri në 5 vjet.

#### *- Gjysmëliria*

Gjysmëliria është një alternativë tjetër të cilën mund ta përfitosh gjatë fazës së dhënies së dënimit apo gjatë kohës kur ke filluar të vuash dënimin me burgim. Në çdo rast, dënimi me burgim nuk duhet të jetë më i lartë se 1 vit. Gjysmëliria jepet për shkak të detyrimeve që mund të keni për të punuar, për t'u arsimuar, kualifikuar ose aftësuar profesionalisht, apo për shkak të përgjegjësive familjare dhe për nevojën për trajtim shëndetësor. Personi që vuan dënimin me gjysmëliri, është i detyruar të kthehet

në burg, pasi të ketë kryer detyrimet jashtë burgut.


#### *- Qëndrimi në shtëpi*

Qëndrimi në shtëpi është alternativa, e cila jepet për dënimet me burgim deri në dy vjet ose kur kjo kohë është pjesë e mbetur e dënimit. Ajo parashikon vuajtjen e dënimit në shtëpinë tuaj, në një shtëpi tjetër private apo në një qendër të kujdesit dhe të shëndetit publik, por kjo vetëm nëse gjendesh në disa rrethana të përcaktuara, si p.sh., nëse je grua shtatzënë ose nënë me fëmijë nën moshën 10 vjeç, nëse je baba me përgjegjësi prindërore për fëmijën, nëse je në kushte të rënda shëndetësore, apo je nën moshën 21 vjeç, me nevoja të dokumentuara shëndetësore, studimore, të punës apo përgjegjësive familjare. Gjykata mund të të lejojë të largohesh nga vendbanimi, për plotësimin e nevojave të domosdoshme familjare, për t'u angazhuar në veprimtari pune, edukimi apo arsimimi ose për programe rehabilitimi, për të cilat Shërbimi i Provës është dakord.

#### *- Lirimi me kusht*

Një tjetër alternativë, e cila zbatohet për personat të cilët nuk janë të dënuar më parë për krime të kryera me dashje është Lirimi me kusht. Në këtë rast mund të lrohesh vetëm për arsye të veçanta dhe nëse me sjelljen dhe punën tënde tregon se me dënimin e vuajtur gjatë kohës së burgimit është arritur qëllimi për edukimin tënd, si dhe të kesh vuajtur:

#### *a) jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;*



*b) jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim;*

*c) jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga pesë gjer në njëzet e pesë vjet burgim.*

### **Fillimi i kërkesës**

Në rast se jeni duke vuajtur dënimin me burgim dhe plotësoni kriteret për ndonjërin nga alternativat e dënimit me burgim, mund t'i drejtosh një kërkesë gjykatës (me asistencën e juristit të IEVP-së ku po vuan dënimin, avokatit/përfaqësuesit tënd ligjor etj.) Në këtë rast, nga Shërbimi i Provës kryhet një proces shqyrtimi, i cili përqëndrohet në vlerësimin e përpjekjeve të deritanishme për rehabilitim, si dhe mundësitë e ardhshme për riintegrim në shoqëri. Pjesë e procesit të vlerësimit janë takimet e specialistit të Shërbimit të Provës me ty, me familjarët e tu dhe me anëtarë të tjerë të rëndësishëm të komunitetit ku jeton.

### **Procesi**

Gjykata merr në shqyrtim kërkesën tënde, së bashku me vlerësimin e kryer nga Shërbimi i Provës dhe mund ta pranohë ose ta rrëzojë atë. Në rast se kërkesa jote pranohet dhe do të vendosesh në njërin prej alternativave të dënimit me burgim, do të jesh nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës për periudhën e caktuar nga gjykata. Gjatë kësaj kohe do të kesh mundësinë të jesh pranë komunitetit, në të cilin të jepet mundësia të shfaqësh përpjekjet e tua për të qenë pjesë e dobishme e tij.

### **Mbikëqyrja**

Për mbarëvajtjen e ecurisë së dënimit alternativ, i cili të është caktuar me vendim gjyqësor, do të jesh nën mbikëqyrje nga Shërbimi i Provës. Kjo nënkupton mbajtjen e një kontakti të shpeshtë me specialistin tënd mbikëqyrës, i cili në sajë të bashkëpunimit tënd do të mund të të asistojë në sfidat apo problematikat e ndryshme që mund të hasësh në rrugën drejt riintegritit në shoqëri.

Gjithashtu, Shërbimi i Provës synon të të ofrojë shërbime të specializuara për të trajtuar nevoja e veçanta që mund të kesh. sic mund të jenë. Këshillimi psikolojik, këshillimi ligjor,